



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.49, datë 23.02.2023

PËR

“ZBATIMIN E VENDIMIT NR.35, DATË 22.11.2022 TË GJYKATËS KUSHTETUESE”

Bazuar në nenin 102, pika 2 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, nenin 12 pika 5 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.35, datë 22.11.2022, VKM-në Nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” të ndryshuar, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Elementi “pagë referuese bazë” i pagës mujore bruto të magjistratit, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.35, datë 22.11.2022, për anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të klasifikohet sipas kategorisë I-b, përfshirë “shtesën për pozicion” dhe “pagën e grupit” sipas grupit 1 të diplomave universitare.
2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore për përlogaritjen e pagave të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga data 09.01.2023.
3. Sekretari i Përgjithshëm të marrë masa për mbulimin e efekteve financiare të krijuara si pasojë e diferencës së shkaktuar në buxhetin e vitit 2023 për fondin “Paga” (llogaria Nr.600), për shkak të zbatimit të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.35, datë 22.11.2022.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 23.02.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi


ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Elaida Goxhi



ANËTAR  
Mirela Bogdani



ANËTAR  
Esmeralda Keshi



ANËTAR  
Arta Mandro



ANËTAR  
Zeqir Hoda



ANËTAR  
Ledina Riza

